



**GRUPI  
KËSHILLIMOR  
I STABILITETIT  
FINANCIAR**

Tiranë, në 20.02.2015

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar,**

**20 shkurt 2015**

-----

Në datën 20 shkurt 2015, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Sipas programit, në fillim të mbledhjes përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, paraqitën një vlerësim mbi ecurinë financiare dhe rreziqet për veprimtarinë e sektorit bankar. Të pranishmit vlerësuan se situata financiare e sektorit bankar është e qëndrueshme dhe e përmirësuar në krahasim me një vit më parë. Veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, aktiviteti i kreditimit ka shfaqur shenja rigjallërimi, të cilat mund të bëhen më të qëndrueshme nëse përmirësohen pritshmëritë për rritjen ekonomike. Depozitat në banka kanë vijuar të rriten, ku kontributin kryesor e kanë dhënë ato të bizneseve, në vijim të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga ana e qeverisë. Të pranishmit analizuan gjithashtu treguesit përkatës të rreziqeve për veprimtarinë bankare dhe vlerësuan ndikimet potenciale nga zhvillimet ekonomike, të brendshme dhe të jashtme. Nga analiza rezultoi që përmirësimi i treguesve financiarë të sektorit ka forcuar qëndrueshmërinë e tij ndaj goditjeve të ndryshme. Me tej, të pranishmit diskutuan rreth ecurisë së zbatimit të

rekomandimeve të FSAP<sup>1</sup>, dhe theksuan nevojën e përshpejtimit të punës sipas angazhimeve të marra.

Në diskutimin e tyre, përfaqësuesit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) theksuan nevojën për të hartuar sa më shpejt protokollin e veprimeve për ushtrimin e mbikëqyrjes së konsoliduar të institucioneve financiare. Të pranishmit vlerësuan rëndësinë e këtij procesi dhe mbështetën propozimin e AMF, duke theksuar nevojën për vendosjen e përparësive dhe përcaktimin e mënyrave më efektive për realizimin e tij.

Mbledhja tjetër e rregullt e GKSF pritet të zhvillohet brenda muajit maj 2015.

---

<sup>1</sup> Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar (*Financial Sector Assessment Program – FSAP*), i cili u realizua në periudhën tetor-nëntor 2013 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.